



Bifrost Holding sh.p.k.  
M32015030A

Rruga Petro Nini Luarasi  
info@bifrost.al  
[www.bifrost.al](http://www.bifrost.al)

Tiranë, më 17.08.2023

**VENDIM Nr. 23.02**  
**I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**  
**“Bifrost Holding” sh.p.k.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë “**Bifrost Holding**” sh.p.k., e përberë nga ortaku i vetëm z. **Fotion Zoga** i cili zotëron 100% të pjesëve të kapitalit themeltar, në përputhje me objektin e aktivitetit të Shoqërisë

**Vendosi :**

1. Të vlerësojë nevojën e Shoqërisë për likuiditete për të kryer investime që i shërbejnë aktivitetit të Shoqërisë. Pasi u morën në shqyrtim situata aktuale financiare dhe nevojat e Shoqërisë, u gjykua e nevojshme të shtohet në Kapital një vlerë prej 9.900.000 (nëntë million e nëntëqind mijë) Lekësh.
2. Të ndryshojë Kapitalin e Shoqërisë duke e rritur atë nga 100.000 (njëqind mijë) Lekë në **10.000.000 (dhjetë milion) Lekë**. Kjo rritje e Kapitalit do të realizohet me anë të një transfertë bankare nga Ortaku.
3. Numri i Kuotave, Pronësia dhe Pjesëmarrja në përqindje nuk ndryshojnë, duke mbetur **1 (një) Kuotë që përbën 100% të Pjesëmarrjes në përqindje**.

Për Asamblenë e Ortakëve  
Ortaku i Vetëm  
Fotion Zoga

*Fotion Zoga*

